

Nr/SH: 01-570  
MDDm: 12.10.2018



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosova  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa  
Z/znj.

Në bazë të dispozitave te nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në  
bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

**F T O J**

Mbledhjen e tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet më  
22.10.2018 ( e hënë ) duke filluar ne ora 10:00.

**Rendi i ditës**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Raporti i komisionit mbi emrin e rrugve në teritorin e komunës së Novo  
Brdës;
3. Vendosja e mbishkrimeve në ndërtesën e Komunës dhe hapsirave zyrtare;
4. Zgjedha e komisionit për ndrimin e statutit;
5. Raporti finaciarë për periudhën tre mujore 2018 (Korik-Shtatorë).
6. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më: 12.09.2018  
Në: Novobërdë



**Kryesues i Kuvendit**  
Nebojsa Arsic

Nr. 01-571  
MDDate: 12.10.2018



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Novobërdës**  
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 18.09.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Anëtarët e KPF-së: Nebojsa Arsic, Xhejlane Behluli, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Predrag Stojkovic, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Zyrtari i Drejtoris së Zhvillimit Ekonomik Driton Mustafa .

Kryesuesi pasi përshëndeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me punën e KPF-së dhe rendin e ditës duhet konstatuar korumin prezentë janë të gjithë antarët e KPF-së, kemi korumin për pune pas kësaj e hapi mbledhjen me këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;
2. Shqyrtimi i propozim bugjetit për vitin 2019 – 2021;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Xhejlane Behluli pasi përshendeti të pranishmit tha: në bashkpunim me grupin e grave të Kuvendit, zyren për barazi gjinore dhe OJQ që janë në Komunën tonë kisha kërku që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe të këtë përkrahje për aktivitete të cilat i kemi parapa ne si grup në këtë plan për përmirësimin e pozites së gruas dhe barazis gjinore, nese shkon në Kuvend kisha kërku përkrahje e jo si më herët vetem të mirret vendimi të nënshkruhet e të mos mirret asnjë iniciativ, ju faleminderit.

Pasi nuk pat propozime tjera rendi i ditës u aporvua njëzëri nga të gjithë anatrët prezent të KPF-së më këtë pikë shtes të propozuar: Shqyrtimi i propozim të Planit Aksional për përmisimin e pozitës së gruas dhe Barazis gjinore në Komunën e Novobërdës për 2019/21;

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF-së;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pat diskutime kjo pikë u votua me 4 vota për dhe 1 apstenim nga antarët e KPF-së.

**Pika e dytë:** Shqyrtimi i propozim bugjetit për vitin 2019 – 2021;

Kryesuesi tha: ashtu si ju kam njofuar edhe në mbledhjen e kaluar jemi në fazen e aprovimit të buxhetit dhe ne mbledhjen e ardhshme duhet ta aprovojm buxhetin e propozuar për vitet 2019/21, për këtë pikë ja dha fjalën Drejtorit të Financave që të na ofroj më shumë informata.

Sercan Todorovic pasi përshendeti të pranishmit tha: unë e kam propozuar këtë pikë për rend dite dhe ju lus që ta aproponi që të shkoj në Kuvend edhe pse materialin e keni pranuar sot. Mbi 2,700,000 € është buxheti total në Komunën e Novobërdës, nga gjithë këto mjete mbi 2,400,000€ janë grant qeveritar dhe mbi 274,000€ janë planifikuar të hyra vetanake, rreth 19,000€ jan obligime Komunale, 1,903,481€ janë të planifikuar për paga dhe meditje, mallra dhe sherbime 309,716€ , shpenzime komunale 66,000€, për subvencione 30,000€ dhe

investime kapitale 472,441€. Pas këtij prezantimi të buxhetit i keni edhe mjetet e ndara sipas drejtorive në kategorit mallra dhe sherbime, paga dhe medite, shpenzime komunale, i keni tabelat e të hyrave në buxhetin Komunal dhe në fund i keni tabelat e investimeve kapitale, nese keni ndonjë pyetje jam i hapur për diskutim, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Xhejlane Behluli tha: e kam një pytje për Drejtorin, pas bisedimeve që pata me grupin e grave me sa e pash nuk ka kod të posaqëm për zyren e barazis gjinore, dmth ka kod për gjështje gjinore por ato u arsyetuan se nuk ka kod, tjetra është se përveq materialit për zyre dhe paga që është e zyrtares nuk ka aktivitetet tjera dhe deri më tanë aktivitetet që i ka organizuar ka kërkuar buxhet prej Administrates.

Sercan Todorovic tha: mjetet të cilat i kemi ndar për mallra dhe sherbime mundë të shfrytëzohen edhe për aktivitete.

Xhejlane Behluli tha: 2,000€ janë pak.

Sercan Todorovic tha: Kryetari i ka ndihmuar aq sa ka pasur nevoj, mirëpo problemi është se nuk mundë të figuroj shifër më e madhe në zyren e barazis gjinore pasi që nuk kemi mjete.

Xhejlane Behluli tha: po pasi që edhe zyrtarja është dekluarar është ndihmuar por në një form tjetër por pasi që egziston kodi pse mos tbarten mjete direkt në këtë zyre por çdo herë duke kërkuar prej Kryetarit.

Driton Mustafa tha: për fillim për zyren e barazis gjinore 2,000 € janë mjaftueshëm për aktivitetet të cilat i organizojn, mirëpo nuk do të that që nuk do ta përkrahim, por arsyaja se pse një pjesë më e madhe e mallrave dhe sherbimeve është në zyre të Kryetarit është sepse Kryetari i Komunës e ka deponimin e nënshkrimit, nuk ka dikush tjetër deponim të nënshkrimit përvëç Kryetarit dhe Kryesuesit të Kuvendit, ne mundemi edhe 5,000€ mi bart në zyren e barazis gjinore mirëpo këto mjete i vendos Kryetari i Komunës, ju faleminderit.

Xhejlane Behluli tha: ndryshe është kur i ke mjete në zyre e ndryshe kur i kërkon çdo herë prej Kryetarit, andaj po kërkoj që të na përkrahni në këtë planë, gjithashtu kisha kërkua nga Drejtori që mos të biem në atë pozit në Kuvend si në mbledhjen e kaluar e ti humbim mjetet, ju kisha lut që ti shikoni afatet kohore.

Selatin Nuhiu pasi përshendetë të pranishmit tha: ne e përkrahmi buxhetin e shpenzimeve operative, sa i përket buxhetit të investimeve kapitale kemi disa propozime, p.sh investimet kapitale që janë material ndertimor kisha kërkua që të transferohen në asfaltim të rrugëve lokale pasi që e dim se Komuna jonë ende ka rrugë të pa asfaltuara, mendoj se projektete e asfaltimit të rrugëve, ndërtimit të kanalizimeve duhet të shkojm me projekte konkrete se cila rrugë do të asfaltohet dhe ku do të ndërtohen kanalizimet apo ndriqimi dhe në cilat lagje. Unë do tju prezantoj disa projekte konkrete në emër të tri subjekteve politike si PDK, AKR dhe VV, sa i përket asfaltimit kemi propozim rrugen në fshatin Llabjan shkollë-Degellaj, projektin e dytë asfaltimin e rrugës ka varrezat në të dy drejtimet, propozimet konkrete për ndërtim të kanalizimit është në fshatin Tullarë lagja e poshtme dhe kanalizimin në fshatin Llabjan të market Migros dhe ndriqimet publike në fshatin Kosaq lagja e eperme, ndriqimi në fshatin Vllasali dhe në fshatin Koznic dhe sa i përket mirëmbajtjes së rrugës e kemi rrugen në lagjen Brusë rregullimin e urës. Ndërsa sa i përket blerjes së paisjeve bujqësore kisha kërkua që prej shumës totale të ndahet një shumë rreth 15,000€ për vaksinimin e kafshëve, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: sa i përket qështjes që e përmendet për material ndertimor besoj që pajtoheni se Komuna e Novobërdës është Komuna më e varfër në Kosovë dhe kemi shumë kërkesa prej qytetarëve kur ata vet e fillojn objektin por nuk kan mundësi me përfundu, ne e kemi komisionin e formuar prej Komunës i cili del ne terren verifikon gjendjen dhe vendos se kujt i dhuron material ndertimor, sa i përket asfaltimit të rrugëve kemi mbajtur debate me qytetarë dhe kemi shumë kërkesa, Kuvendi pas aprovimit të buxhetit do ti shohim se cilat pjesë të rrugë mund ti mbulojm, sa i përket ndriqimit mos të na ndodh të ndajm mjete pasi që i kemi disa propozime që do të kemi donacione për ndriqim, sa i përket vaksinimit menoj se Ministria e Bujqësisë e kryen vaksinimin.

Kryesuesi tha: vetem ky komision po punojka pasi që të gjitha komisionet e tjera të formuara nuk po funksionojn. Problemi tjetër është problemi i kanalizimit në Kufc nuk është që 2 - 3 muaj por para 3 - 4 viteve.

Selatin Nuhiu tha: edhe ne kem biseduar me qytetarë dhe këto projekte të cilat i propozova më shumë janë të palës shqiptare dhe besoj se është mirë mu realizu ato projekte. Sa i përket komisioneve ne prej Kuvendit nuk kem qasje për dhënje të materialit ndërtimor, unë jam në tri komisione tjera dhe asnjë herë nuk jam ftu në takim.

Milica Jovanovic pasi përvendetë të pranishmit tha: i kam disa propozime sa i përket komunitetit serb, është një pjesë e rrugës prej kishes Sveti Nikola deri në Makreshë të epërm pastaj rrugen të ferma e kuzhines popullore, dhe rrugen Kufc - Stanishor - Kufc.

Xhejlane Behluli tha: nuk jam e knaqur me debatin është mirë me u dit cili e ka fjalën dhe perkthyesi vetem duhet me perkthys, nuk e kuptova se çka biseduat me Drejtoren për kanalizim. Sa i përket propozimeve të partive tjera i kisha përkrahë sikur të ishin të gjitha fshatrat e përfshirë pasi që fshati Pasjak ka shumë rrugë pa asfaltume, gjithashtu edhe në fshatin Stanishor e jo ti cekni vetem problemet e votuesve tuaj.

Sercan Todorovic tha: i dëgjova propozimet për buxhet dhe sikur të ishte totali i buxhetit vetem për investime kapitale nuk do ti kisha realizuar të gjitha projektet. Buxheti duhet të shkoj në Kuvend dhe duhet të aprovohet mandej ne të gjithë së bashku më këtë buxhet që e kemi do të shohim mundësit se cilat projekte mund ti mbulojmë.

Kryesuesi tha: vetem një pyetje për ndarje të mjeteve për material ndërtimor nese një qytetarë i përfiton 200 bloka, pak armatur dhe cement çka është këtu kapitale?. Te tabela 4.3 Taksat Komunale për vitin e kaluar kanë qenë 76,732€, për këtë vit janë 46,732 ndërsa për tri vitet e ardhshme janë 141,895€.

Driton Mustafa tha: në këto taksa Komunale bëjnë pjesë qertifikatat dhe dokumentet tjera zyrtare , taksat e pasijeve motorike, taksat tjera Komunale, këto tri lloje të taksave mbledhen dhe na jep rezultatin e taksave Komunale.

Kryesuesi tha: a janë reale këto shuma.

Driton Mustafa tha: a janë reale apo jo këto mjete na ka ndar Ministra e Financave dhe ne duhet ti inkasojm, kur e ka kërkuar Ministria e Financave planin e të hyrave për me i realizu Komuna e Novobërdës ne ja kemi dërguar planin e mëhershëm me 180,000€ pasi që kjo shumë është reale që në mundemi mi inkasu ata e kanë atë të drejt që ta planifikojn ashtu si dojn vet.

Selatin Nuhiu tha: te taksat e pasijeve motorike i keni pasur 14,716€, për vitin e ardhshëm i ke bërë 33,016 € dmth i ke dyfishuar rritjen kjo për mua është e paarritshme, te taksat tjera Komunale për vitin e kaluar kanë qenë 50,792 € për këtë vit kemi rënje drastike pre 20,792 € ndërsa për 2019 është e parapame 104,879 € kjo është shumë apsurde, te bashkpagesat për shendetësi prej 1,320€ sa kan qenë i keni rrit në 6,716€. Sa i përket Drejtoret pasi që tha janë shumë projekte, nashta po tinglojnë shumë si projekte por të kemi parasysh pasi që këto janë rrugë të shkurta dhe me një shumë të vogel mjetesh mundë të rregullohen, ju faleminderit.

Driton Mustafa tha: nese më dëgjove më herët e ceka se të hyrat na janë planifikuar padrejtësishtë prej Ministrisë së Financave pasi që na është rrit për 100,000€, ndërsa realja për inkasim te ne është rreth 180,000€ dhe nuk ka asnjë apsurde. Te ne i vetmi burim i të hyrave të sigurta është tatimi në pronë. Pra këtë buxhet të cilin e keni para vetes është i punuar në mënyren më profesionale në bazë të qarkores buxhetore të cilin e ka dërguar Ministria e Financave.

Selatin Nuhiu tha: për këtë arsyje pasi që kemi kërkesa shumë për rrugë po kërkojm që mjetet e ndara për material ndërtimor të transferohen në asfaltim të rrugëve, sa i përket draft buxhetit ky buxhet që na prezantuat sot po dallon me buxhetin e mëhershëm.

Driton Mustafa tha: asnjë ndryshim nuk është sa i përket shifrave finale, në Drejtori mundet të ndryshoj vetem paga dhe meditje.

Xhejlane Behluli tha: nuk jam kundër Drejtorisë së Financave pasi që këta e kan perfunduar punën e vet por qytetarët nuk janë të vediuar dhe nuk kërkojnë asnjë, po flas për fshatin Pasjak pjesëmarrja e qytetarëve ne debat ishte shumë e vogël, por nese ato prioritetë qe i paraqiten qytetarët realizohen unë jam shumë e kanqur. Sa i përket komisioneve jam Kryetare e Komisionit për rregulloren e tatimit në pronë, nuk është se skam punuar, personalisht kam kontaktuar USAID kan qenë në pushime, kam biseduar me Edmondin përfaqshuesin e OSBE-es dhe më ka ofruar përkrahje në raport me ligjin dhe duku u konsultuar me Ministrin e Financave, gjithashtu kam kontaktuar direkt edhe me Ministrin dhe do të raportoj në Kuvend kur të propozohet rregullorja e tatimit në pronë atëher ju prezantoj edhe planin pasi që ne si komision vetem formohemi por nuk kemi mundësi me ndryshu asnjë.

Selatin Nuhiu tha: sa i përket kësaj rregullore Drejtoria e Financave duhet ta sjell me buxhet edhe rregulloren e tatimit në pronë pasi që është pjesë e draft buxhetit.

Sercan Todorovic tha: në fund të nënitorit e kemi afatin për ta dërguar në Ministri dhe e prezantojm në Kuvend.

Kryesuesi tha: i kemi përmendur shumë qështje por gjendja në arsim dhe shendetësi si është?

Sercan Todorovic tha: 25,000€ i kemi mallra dhe sherbime në shendetësi dhe 5,000€ shpenzime komunale që shfrytëzohen për gelqerosje të ambulantave. Duke e pasur parasysh që në zyren e Kryetarin te kodi mallra dhe sherbime janë 140,000€ nese është e nevojshme Kryetari do të intervenoj në bartje të mjeteve.

Kryesuesi tha: 25,000€ mendoj se janë pak, pasi që kemi shumë nevoj të investojm në ambulanta.

Sercan Todorovic tha: fatkeqësisht buxhetin e kemi më të vogël dhe me këtë buxhet e kemi vështir ti mbulojm të gjitha ambulantat pasi që gjithsej i kemi 9, në arsim e kemi rritur pak shumën për mallra dhe sherbime por buxheti në arsim ndahet në bazë të numrit të nxënësve.

Kryesuesi tha: nese nuk ka diskutime tjera e kalojmë ne votim që këtë pikë ta dergojm në Kuvend.

Pasi nuk pat diskutime tjera kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-së që të shkoj në Kuvend.

**Pika e tretë:** Shqyrimi i propozim të Planit Aksional për përmisimin e pozitës së gruas dhe Barazis gjinore në Komunën e Novobërdës për 2019/21;

Kryesuesi e hapi diskutimin

Pasi nuk pat diskutime kjo pikë u votua njëzëri nga të gjithë antarët e KPF-së që të shkoj në Kuvend.

**Pika e pestë:** Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Milica Jovanovic tha: e dini se për fermeret e dëmtuar nga vjedhjet janë ndarë 5,000€ e kemi formuar edhe komisionin kishte qenë mirë që në mbledhjen e ardhshme të na informoj ai komision se çka ka punuar a i ka ndihmuar dikujt, gjithashtu tju njoftoj se edhe mbrëmë ka ndodhur nje vjedhje dhe ky është problem i madhë.

Kryesuesi tha: ato mjete që janë ndarë a kan filluar procedurat për sigurimin e atyre kafshëve apo skan filluar ne nuk kemi asnje informatë.

Predrag Stojkovic pasi përshendetë të pranishmit tha: rrëth këtyre komisioneve e kam një pyetje pasi që ato janë formuar por a jan konsultuar zyrtarisht nuk e di, por në mbledhjen e parë të gjitha komisionet të cilat formohet i fton Kryesuesi, të gjitha komisionet të cilat formohen i raportojn Kuvendit se pse këto komisione nuk janë duke funksionuar, Kryetari i komisionit të formuar a i ka derguar raport Kuvend se pse këto komisione nuk janë duke punuar, po e bartmi fajin te tjert por përgjegjës jemi ne, diçka të rëndësishme që dua të them është se çdo komision që formohet duhet të formohet në bashkëpunim më këshillin egzekutiv përveç komisionet që janë përgjegjësi e plotë e Kuvendit.

Komisioni që është formuar për kompenzim të fermerve të dëmtuar është duhur të formohet në bashkëpunim me këshillin egzekutiv.

Kryesuesi tha: ne si Kuvend i kemi formuar komisionet ne jemi konsultaur dhe e kemi zgjedhur Kryetarin e Komisioneve, a punojn apo jo është qështje tjeter. Xhevat Mehmeti është Kryetari i komisionit për dhënje të tokës në shfrytëzim por tani nuk është më antarë i Kuvendit dhe më nuk mundë të jetë antarë i atij komisioni.

Predrag Stojkovic tha: mendoj se ky komision duhet të formohet përsëri pasi duhet ti përbahemi procedurave ligjore, ka procedura, ka obligime ligjore të cilave duhet ti përbahemi dhe ato procedura fillojn prej Kryetarit të Komunës për dhënje të tokës në shfrytëzim, shpallet tenderi për të gjithë të interesuarit për at tokë dhe në bazë të fteses publike zgjedhet kandidati më i mirë.

Kryesuesi tha: ne e kemi derguar vendimin e Kuvendit në Ministri dhe kemi marrë pergjigjje se është në bazë të ligjit.

Xhejlane Behluli tha: kur jan propozuar 5000€ për kompenzim të fermerve ka qenë prezent edhe Kryetari dhe ka mundur ti prezantoj 2 ose 3 antarë për komisionit prej egzekutivit dhe ne ti zgjedhshim të tjerët prej Kuvendit. Të gjitha komisionet në Komunat tjera paguhen vetem në Komunën tonë nuk paguhen. Unë jam interesuar në komisioni që jam për rregulloren e tatimit në pronë dhe nese ju kërkon në mbledhjen e ardhshme ju sjell pa problem planifikimin e Ministrisë ju raportoj për të gjitha por unë e kam lënë këtë raport kur të vie propozimi i rregullores.

Predrag Stojkovic tha: Kuvendi e ka për obligim tju ofroj kushte komisioneve që ata të funksionojnë, pasi që jan komisione obligative dhe që formohen prej Kuvendit, Kuvendi duhet më kohë ta planifikoj buxhetin.

Xhejlane Behluli tha: jemi interesuar me punu por nuk kemi pas se çfarë të punojmë, perderisa unë nuk kam drejt mi ndrru zonat unë nuk jam për me thy ligjin pasi që Ministria i ka planet e veta, p.sh ne tetor bëhet rivlersimi i të gjitha tokave, në vitin e ardhshëm të gjitha tokat bujqësore tatimohen, në vitin 2020 çmimi i zonave nuk ndryshon.

Predrag Stojkovic tha: kam qenë antarë i këtij komisioni, kam provuar ta ndihmoj këtë komision ka agjensione të cilat mirren me këto planifikime, duke pasur parasysh se në kuader të një zone mund të kemi nën zona por kemi pasur një komision jo serioz .

Xhejlane Behluli tha: une fola me fjal të Ministris dhe nese ju keni ndonjë kontak i cili mundë të më ndihmoj jam e gatshme të punojë.

Milica Jovanovic tha: ne duhet ta kontaktojm komisioni per ndarje te mjeteve fermerve të demtuar nga vjedhjet pasi që po flitet se ato mjete janë ndarë.

Selatin Nuhiu tha: ne si komision jo vetem se nuk po na plotësohen kushtet po as nuk po na ftojn në Kuvend dhe si duket nuk ka bashkpunim legjislativ – egekutiv, ne vetem jemi sa me plotësu këtë zbrazëtin ligjore pasi që askush nuk na merr ne parasysh.

Xhejlane Behluli tha: unë vet jam ballafaquar diten e parë që jam zgjedhur Kryetari pasi që tre antarët e zgjedhur në at komision nga Kryetari më kan thën se asgjë nuk do të përmirësosh, e përkrahi kolegut që ne duhet të kemi bashkpunim.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i falemendëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30

Procesëmbajtëse

Valmire Mustafa




Kryesues i Kuvendit

Nebojsa Arsic

05-524  
15.10.2018



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



*RAPORTI FINANCIAR*

*TË HYRAVE DHE TË DALURAVE PËR PERIUDHËN*

*KORRIK - SHTATOR 2018*

*TETOR - 2018*

**Shfrytezimi i te hyrave dh te dalurave te shfrytezueseve buxhetor per periudhen Korrik-shtator 2018**

**Per te pasur nje pasqyr te shfrytezuesve buxhetor po ju paraqesim reportin e shpenzimeve te planifikuara dhe te realizuara per periudhen Korrik-shtator 2018**

Nr	Shfrytezuesit e buxhetit	Kod	Kodi i Drejtoris
1	Zyra e Kryetarit		16030
2	Administrata		16330
3	Zyra per komunikim		16490
4	Zyra per barayi gjinore		16530
5	Zyra e kuvendit komunal		16930
6	Buxhet dhe financa		17530
7	Inspeksioni		16659
8	Sherbimet publike - mbrojtja civile		18190
9	Zyra per komunitete		19650
10	Bujqesi, pylltari dhe zhvill.rur.		47030
11	Zhvillim ekonomik		48030
12	Urbanizem		66455
13	Shendetesi dhe mbrojtje prim. Shend.		74800
14	Sherbimet sociale		75645
15	Kultur rini dhe sport		85030
16	Administrata arsim		92150
17	Arsim i mesem		95070
18	Arsim fillor		93870
19	Arsimi parashkollor kopshjet		92790

Inkasimi eshte bere ne baze te Regullores mbi taksat, ngarkesat dhe kamatat si dhe Regullores per tatimin ne pro

Per tre mujorin e trete 2018 kemi keto te hyra:

Te hyrat vetanak per periudhen Korrik, Gusht, Shtator

Kodi ekonomik	Te hyrat	shuma
40110	Te hyrat nga tatimi ne pron	15,704.15
50001	Te hyrat nga regj. I automjeteve	5,150.00
50009	Taksa komunale per leje te ndertimit	7,936.02
50011	Taksa komunale per regjistrimin e trasheg	610.00
50012	Taksa per ndrrimin e destinationit te tokes	11,544.00
50013	Taksa per qertifikatat e lindjes	1,095.00
50014	Taksa per qertifikatat e kunorezimit	178.00
50015	Taksa per qertifikata te vdjekes	111.00
50019	Taksa tjera administrative	544.00
50025	Taksa per vertetimet prej 1€	2.00
50019	Taksa tjera administrative - Lista poseduse	485.00
50019	Qiraja nga objektet publike	3,026.00
50408	Qiraja nga prona publike	0.00
50405	Participimi ne shendetesi	600.00
50111	<b>Gjithsejt</b>	3,969.60
50409	Participacija zdravstva	127.20
<b>UKUPNO:</b>		<b>51,081.97</b>

**MJETET E SHPENZUARA**

Sipas shfrytuesve te njesive buxhetore

Nr	Shfrytuesi i buxhetit	Paga dhe medite	marrë dhe shembime	Shpenzimet komunale	Subvencionet te shpenzuara	Investimet kapitale te shpenzuara
1	Zyra e Kryetarit	Te planifikusa 17,389.50 €	te shpenzuara 16,424.95 €	Ite shpenzuara 19,791.02 €	te shpenzuara	2,516.50 €
2	Administrata	41,683.50 €	40,618.94 €	5,103.22 €	te shpenzuara	
3	Zyra per komunikim	1,332.50 €	1,278.60 €			
4	Zyra per barayi gjinore	1,837.50 €	1,781.82 €			
5	Zyra e kuvernit komunal	18,750.00 €	15,892.13 €	875.49 €		
6	Buhxet dhe financa	11,692.25 €	11,591.64 €	6,796.33 €		
7	Inspektioni	8,371.75 €	6,287.04 €			
8	Sherbimet publike - mbrojtja civile	18,667.50 €	17,948.20 €	398.20 €		57,597.87 €
9	Zyra per komunitete	7,807.25 €	7,725.84 €			
10	Bujqesi, pylltari dhe zhvill rur.	11,454.00 €	11,018.91 €			
11	Zhvillim ekonomik	7,206.50 €	6,670.45 €			
12	Urbanizem	10,749.50 €	9,740.38 €	697.00 €		70,157.41 €
13	Sherdetesi dhe mbrojtje prim. Shend.	58,829.00 €	58,565.49 €	3,934.08 €	367.00 €	
14	Sherbimet sociale	6,253.25 €	5,993.91 €		2,980.00 €	
15	Kultur rini dhe sport	9,361.00 €	10,161.93 €		3,236.00 €	
16	Administrata arsim	9,547.50 €	7,649.01 €			
17	Arsim i mesem	47,040.25 €	48,097.53 €	2,000.00 €		
18	Arsim fillor	181,112.75 €	182,924.84 €	11,459.28 €		
19	Arsimi parashkollar kopshjet	3,275.00 €	3,123.09 €			
	Gjithsejt	472,360.50 €	463,494.70 €	51,054.62 €	13,332.30 €	2,516.50 €
						127,755.28 €

Mjetet e planifikua per tremujorin e trete 2016 per pagë dhe mëdijë kanë qene ne vler prej 472,360.50 Euro kurse te shpenzuara janë ne vler prej 463,494.70 Euro ne perqindje eshte 98.12 %

Per malira dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 51,054.62 Euro.

Per shpenzime komunale janë shpenzuar mijete me vlerë prej 13,332.30 Euro

Per subvencione janë shpenzuar mijete ne vler prej 2,516.50 Euro

Per investime kapitale janë shpenzuar ne vler prej 127,755.28 Euro.

**ZYRA E KRYETARIT 16030**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik - shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Subvencione	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	4.872,07 €	shpenz. tjef te kontra.	7.459,22 €			
2	Paga	Gusht	5.776,44 €	Paga	1.745,16 €	Subvent. jo publ.	2.516,50 €	
3	Paga	Shtator	5.776,44 €	furniz. per zyre	1.331,17 €			
				shpenz. telef.	1.050,00 €			
				Regist. vetur.	75,00 €			
				sigurimi i vetur.	221,78 €			
				Dreka	198,00 €			
				Derivate	3.906,19 €			
				Ushqim dhe pije	862,20 €			
				Furniz.pais medici.	1.950,00 €			
				furniz. mat. higi.	982,30 €			
	<b>Gjithsej</b>				<b>16,424,95 €</b>		<b>2,516,50 €</b>	<b>38,732,47 €</b>

Per Paga dhe Mediteje kane qene te planifikuara ne vler prej 17,389,50 Euro, kurse te shpenzuara jene 16,424,95 Euro, ne perqindje eshte 94,50 %.  
 Per malira dhe shetbime jene shpenzuar ne vler prej 19,791,02 Euro  
 Per subvencione jene shpenzuar mijete ne vler prej 2,516,50 Euro.

**ADMINISTRATA 16330**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Subvencione	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	13,518,98 €	Paga	2.090,32 €	Riyma	6.749,30 €	
2	Paga	Gusht	13,549,98 €	furniz. per zyre	198,90 €			
3	Paga	Shtator	13,549,98 €	furniz. me dru	1.098,00 €			
				shpenz. telef.	56,00 €			
				dreka	91,00 €			
				shpenz. marketing	250,00 €			
				Shpenzime. E tjef te ko.	1.214,00 €			
				Regist. i vetur.	105,00 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>40,618,94 €</b>		<b>5,103,22 €</b>		<b>6,749,30 €</b>	<b>52,471,46 €</b>

Per Paga dhe Mediteje kane qene te planifikuara ne vler prej 41,683,50 Euro, kurse te shpenzuara jene 40,618,94 Euro, ne perqindje eshte 97,50 %.  
 Per malira dhe shetbime jene shpenzuar ne vler prej 5,103,22 Euro  
 Per shpenzime komunale jene shpenzuar mijete me vlera prej 6,749,30 Euro.

**ZYRA PER KOMUNIKIM 16490**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	426,20 €			
2	Paga	Gusht	426,20 €			
3	Paga	Shtator	426,20 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>1.278,60 €</b>			<b>1.278,60 €</b>

Per Paga dhe Mediteje kane qene te planifikuara ne vler prej 1,332,50 Euro, kurse te shpenzuara jene 1,278,50 Euro, ne perqindje eshte 96,00 %.

**ZYRA PER BARAZI GUJINORE 16530**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	593.94 €			
2	Paga	Gusht	593.94 €			
3	Paga	Shtator	593.94 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>1,781.82 €</b>			<b>1,781.82 €</b>

Per Paga dhe Mediteje kane qene te planifikara ne vler prej 1,837.50 Euro. kurse te shpenzuara jane 1,781.82 Euro, ne perqindje eshte 96.96 %.

**ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL 16930**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	5.967.38 €	furniz.per zyre	175.41 €	
2	Paga	Gusht	4.891.97 €	ushqim dhe pije	700.08 €	
3	Paga	Shtator	5.032.78 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>15.892.13 €</b>		<b>875.49 €</b>	<b>16.767.62 €</b>

Per Paga dhe Mediteje kane qene te planifikara ne vler prej 18,750.00 Euro, kurse te shpenzuara jane 15.892.13 Euro, ne perqindje eshte 85.00 %.

Per malira dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 875.49 Euro

**BUXHET DHE FINANCA 17530**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	3.853.71 €	Shpenzime E tjerrje ka	294.90 €	
2	Paga	Gusht	3.853.71 €	furniz.per zyre	556.53 €	
3	Paga	Shtator	3.884.22 €	ustroim dhe pije	748.50 €	
				dleka	113.70 €	
				Regist i vetur.	75.00 €	
				furniz.më lop	4.320.00 €	
				shpenz.telef.	361.90 €	
				sigurimi i vetur.	247.80 €	
				shpenz.e meditjes	78.00 €	
	<b>Gjithsej</b>		<b>11.591.64 €</b>		<b>6.796.33 €</b>	<b>18.387.97 €</b>

Per Paga dhe Mecitje kane qene te planifikara ne vler prej 11.692.25 Euro, kurse te shpenzuara Jane 11.591.64 Euro, ne perqindje eshte 99.00 %.

**INSPEKSIONI 16659**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mail.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	2.344.89 €			
2	Paga	Gusht	1.597.26 €			
3	Paga	Shtator	2.344.89 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>6.287.04 €</b>		<b>- €</b>	<b>6.287.04 €</b>

Per Paga dhe Mediteje kane qene te planifikara ne vler prej 8.371.75 Euro, kurse te shpenzuara Jane 6.287.04 Euro, ne perqindje eshte 72.00 %.

**SHERBIME PUBLIKE** 18190

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Invest.Kapitale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	5.728.98 €	furniz per zyre	398.20 €	mimbajt rug lokale	57.597.87 €	
2	Paga	Gusht	6.109.61 €					
3	Paga	Shtator	6.109.61 €					
	Gjithsej		17.948.20 €		398.20 €		57.597.87 €	75.944.27 €

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 18.667.50 Euro, kurse te shpenzuara jane 17.948.20 Euro, ne perqindje eshte 96.00 %  
Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 398.20Euro  
Per investime kapitale jane shpenzuar ne vler prej 57.597.87 Euro.

**ZYRA PER KOMUNITETE** 19650

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	2.575.28 €			
2	Paga	Gusht	2.575.28 €			
3	Paga	Shtator	2.575.28 €			
	Gjithsej		7.725.84 €		7.725.84 €	

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 7.807.25 Euro, kurse te shpenzuara jane 7.725.84 Euro, ne perqindje eshte 98.95 %.

**BUJQESI PYLL TARI DHE ZHVILLIM RURAL** 47030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Invest.Kapitale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	€3.672.97			
2	Paga	Gusht	€3.672.97			
3	Paga	Shtator	€3.672.97			
	Gjithsej		€11.018.91	€0.00	€11.018.91	

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 11.454.00 Euro, kurse te shpenzuara Jane 11.018.91 Euro, ne perqindje eshte 95.20 %

**ZHVILLIM EKONOMIK** 48030

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Invest.Kapitale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	€1.958.81			Materi ndirimor	4.007.40 €	
2	Paga	Gusht	€2.339.44			Permbanues privat	10.538.18 €	
3	Paga	Shtator	€2.372.20			Partici ne projekte	8.130.00 €	
						Hartimi i projekteve	15.204.24 €	
						furniz me aspar Gleod	9.615.00 €	
						Permbanues privat	2.972.40 €	
						asfalt Rrug lokale	19.690.19 €	
	Gjithsej		€6.670.45				70.157.41 €	76.827.86 €

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 7.206.50 Euro, kurse te shpenzuara Jane 6.670.45 Euro, ne perqindje eshte 92.50 %

Per investime kapitale Jane shpenzuar ne vler prej 70.157.41 Evra.

**URBANIZEM 66455**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	2.700.89 €	Plate	350.00 €	
2	Paga	Gusht	3.893.56 €	shpenz. e tjer tekomtr.	347.00 €	
3	Paga	Shtator	3.145.93 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>9.740.38 €</b>		<b>697.00 €</b>	<b>9.740.38 €</b>

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 10,749.50 Euro, kurse te shpenzuara jane 9,740.38 Euro, ne perqindje eshte 90.60%  
Per mallra dhe sherbime Jane shpenzuar ne vler prej 697.00 Euro

**SHENDETESIA PRIMARE DHE MIRQENIA 74800**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	shpenz.komunale	vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	19.521.83 €	furniz me pelet	850.00 €	Rryma	367.00 €	
2	Paga	Gusht	19.521.83 €	ushqim dhe piye	103.50 €			
3	Paga	Shtator	19.521.83 €	Regjist.vetur.	150.00 €			
				shpenz.telef.	1.000.00 €			
				sigurimi i vetur.	539.08 €			
				furniz me pais.medic.	1.291.50 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>58.565.49 €</b>		<b>3.934.08 €</b>			<b>367.00 €</b>
								<b>58.932.49 €</b>

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 58,829.00 Euro, kurse te shpenzuara jane 58,565.49 Euro, ne perqindje eshte 99.50 %

Per shpenzime komunale Jane shpenzuar mijte me vtere prej 367.00 Euro.

Per mallra dhe sherbime Jane shpenzuar ne vler prej 3,934.08 Euro

**SHERBIMET SOCIALE 75646**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	shpenz.komunale	vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	1.997.97 €			Rryma	2.960.00 €	
2	Paga	Gusht	1.997.97 €					
3	Paga	Shtator	1.997.97 €					
	<b>Gjithsej</b>		<b>5.993.91 €</b>					<b>2.980.00 €</b>
								<b>5.993.91 €</b>

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 6,253.25 Euro, kurse te shpenzuara Jane 5,993.91 Euro, ne perqindje eshte 95.85 %.

Per shpenzime komunale Jane shpenzuar miete me vtere prej 2,980.00 Euro.

**KULTUR RINI DHE SPORT 85030**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik - shtator - 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	shpenz.komunale rrjma	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	3.387.31 €				3.236.00 €	
2	Paga	Gusht	3.387.31 €					
3	Paga	Shtator	3.387.31 €					
	<b>Gjithsej</b>		<b>10.161.93 €</b>				<b>3.236.00 €</b>	<b>13.397.93 €</b>

Per Paga dhe Meditje kane qene te planifikuar ne vler prej 9.361.00 Euro, kurse te shpenzuara jane 10.161.93 Euro, ne perqindje eshte 108.50%.

Per shpenzime komunale jane shpenzuar mijte me vler prej 3.236.00 Euro.

**ADMINISTRATA NE ARSIM 92150**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik - shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	shpenz.komunale	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	2.549.67 €					
2	Paga	Gusht	2.549.67 €					
3	Paga	Shtator	2.549.67 €					
	<b>Gjithsej</b>		<b>7.649.01 €</b>				<b>7.649.01 €</b>	

Per Paga dhe Meditje kane qene te planifikuar ne vler prej 9.547.00 Euro, kurse te shpenzuara jane 7.649.01 Euro, ne perqindje eshte 80.00%.

**ARSIMI I MESEM 95070**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik - shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	16.032.51 €	furniz me pelet	2.000.00 €	
2	Paga	Gusht	16.032.51 €			
3	Paga	Shtator	16.032.51 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>48.097.53 €</b>		<b>2.000.00 €</b>	<b>50.097.53 €</b>

Per Paga dhe Meditje kane qene te planifikuar ne vler prej 47.040.25Euro, kurse te shpenzuara jane 48.097.53 Euro, ne perqindje eshte 102.00%.

Per mallra dhe sherbime jane shpenzuar ne vler prej 2.000.00 Euro

**ARSIMI FILLOR 93870**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik - shtator - 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Mall.dhe sherb.	Vlera	Gjithsej
1	Paga	Korrik	60.812.64 €	trans 1 nxensë	3.425.58 €	
2	Paga	Gusht	60.873.88 €	furniz me dru	8.033.70 €	
3	Paga	Shtator	61.238.32 €			
	<b>Gjithsej</b>		<b>182.924.84 €</b>		<b>11.459.28 €</b>	<b>194.384.12 €</b>

Per Paga dhe Meditje kane qene te planifikuar ne vler prej 181.112.75 Euro, kurse te shpenzuara jane 182.924.84, Euro, ne perqindje eshte 101.00%.

Per mallra dhe sherbime Jane shpenzuar ne vler prej 11.459.28 Euro

**KOPSHTET DHE ARSIMI PARASHKOLLOR**

Pasqyra tabelare e shpenzimeve per periudhen korrik-shtator- 2018

Nr	Lloji i shpenzimeve	Muaji	Paga	Githsej
1	Paga	Korrik	1.041.03 €	
2	Paga	Gusht	1.041.03 €	
3	Paga	Shtator	1.041.03 €	
	Githsej		3.123.09 €	3.123.09 €

Per Paga dhe Medite kane qene te planifikuar ne vler prej 3.275.00 Euro, kurse te shpenzuara janë 3.123.09 Euro, ne perqindje eshte 95.30 %.

z. Srdjan Todorovic  
Drejtori per Buxhet dhe Financa

z. Svetislav Ivanovic  
Kryetar i Komunes

